



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 558

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Zborc

E martë, më 13 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 17:50 –18:40

Vendi i takimit: SHMFU “Abdullah Shabani”

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, z. Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe njëherit i ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar. Gjatë fjalimit, z. Ademi dha informata për banorët e fshatit Zborc rreth investimeve të cilat do të bëhen dhe kërkoi nga banorët që të bëjnë me dije nevojat e tyre që ne si komunë t'i vendosim në buxhetin e vitit 2024 dhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Për sqarime më të hollësishme z. Ademi ai ia kaloi fjalën Drejtorit të Planifikimit Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini.

Z. Emini së pari kërkoi falje për vonesën e investimeve në këtë fshat dhe tregoi që 70 mijë euro janë të planifikuara sa i përket këtij viti, duke dhënë sqarime shtesë se në cilat rrugë do të investohet. Më pas, Drejtori Emini luti banorët e fshatit Zborc që t'i paraqesin kërkesat e tyre, pasi edhe kjo ishte arsyeja pse ne ishim aty që së bashku të vendosim se në cilat pjesë është më me rëndësi të investohet për vitin 2024.

Kërkesat e banorëve të fshatit Zborc:

- **Safet Haziri:** Të renovohej shkolla e fshatit dhe të shtrohet asfalti të varrezat;
- **Valdet Kurti:** Dy deponi të mbeturinave të hiqen dhe në të njëjtën kohë të sigurohet që nuk do të hedhen më, si dhe të bëhet ndriqimi në tërë fshatin dhe transporti i nxënësve;
- Të rregullohet ujësjellësi, rruga “1 maji”, si dhe tek lagjja e Topillëve (varri i bardhë, prej rrugës “Hafir Bajrami” deri tek rruga e Blinajës) të shtrohen me rrugë të arave;

- **Sali Nuredini:** Të rregullohet problemi me kanalizim tek lagjja e “Topillëve”;
- **Selman Kadriu:** Te lagjja e “Badraxhinjve”, të rregullohet kanalizimi, ndriqimi dhe trotuaret. Të shtohen pengesat në rrugë dhe të këtë më shumë patrolla të policisë;
- **Fadil Xhemajli:** Të rregullohet kanalizimi 60 metra në rrugën e Reçakut;
- **Skender Kadriu:** Në rrugën “Qëndresa” të rregullohet kanalizimi dhe asfalti;
- **Sabit Nuredini:** Të rregullohet asfalti në rrugën “Hafir Bajrami”, tek lagjja e Topillëve;
- **Idriz Mehmeti:** Tre pengesa të vendosen në hyrje të fshatit, ndriqimi në tërë fshatin dhe të largohen deponitë e mbeturinave;
- **Sabri Nuredini:** Të gjitha lagjet e fshatit të pajisen me trotuare.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi: Zborc

Date: 13.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Qendrim Huredini	
2	ILIR ALILI	
3	Shpnesim Nuredini	
4	Sabri Nuredini	
5	ARDIAN BAKRAMI	
6	Safet Haxhi	
7	Adem Ag. Dha	
8	SALIK BAKR	
9	Emvan Mehmeti	
10	NAZI Mehmet	
11	Valdet Kurti	
12	Selman Hadri	
13	Idriz Mehmeti	
14	Valmir Nuredini	
15	FADIL METEVI	
16	Ykendi Hod	

17 SABIT HUREDINI

18 Gresa Bishimi